

KOMUNA E BOGOVINËS

NJOFTIM

Të nderuar qytetarë,

Njoftohen qytetarët e Komunës së Bogovinës që janë obligues tatimor në bazë të tatimit në pronë dhe të gjithë personat juridik dhe tregtarët individual, obligues në bazë të taksës komunale dhe tatimit në pronë se administrata e Komunës së Bogovinës ka bërë shpërndarjen e vendimeve për tatim në pronë dhe taksë komunale për vitin 2018. Komuna e Bogovinës i fton të gjithë obliguesit tatimor të cilët gjatë shpërndarjes që për çfarëdo arsye nuk i kanë pranuar vendimet për tatim në pronë dhe taksë komunale, që të vijnë në zyrat e Komunës dhe ti marrin këto vendime dhe informata tjera në lidhje me detyrimet tatimore ndaj Komunës së Bogovinës. Afati i përmbushjes (pagesës) së detyrimit tatimor në bazë të Ligjit për tatime në pronë është deri më 15.11.2018.

U bëjmë thirrje të gjithë obliguesve tatimor që të shlyejnë borxhet e viteve të mëhershme për tatim në pronë si dhe tatimin në pronë të vitit aktual deri në afatin e përcaktuar me ligj.

Me pagesën e tatimeve dhe taksave paratë tuaja shkojnë direkt në Buxhetin e Komunës, të cilat pastaj u kthehen juve në formë të investimeve publike (përmirësim të infrastruktures, furnizim me ujë, kanalizime, ambient të pastër, shkolla të reja).

Përmbushni obligimin tuaj ligjor dhe qytetarë, paguani tatimet dhe taksat me ndergjegjen tuaj kontriboni në përmirësim të infrastrukturës dhe përmirësim të kushteve për jetesë në Komunën tonë.

Me respekt,

Albon Xhemaili,

Kryetar i Komunës së Bogovinës

